

KAPITULLI 1
IDENTITETI
Arsimi i mesëm

Të zgjedhim
Ne formojmë jetën tonë,
por edhe të të tjerëve

1.1 Këndvështrimet për zgjedhjet dhe identitetin
Me pikëpamjet e kujt mund të pajtohem unë?

1.2 Duke parë pas: çfarë zgjedhjesh më bënë mua personin që jam?
Cilat zgjedhje kanë pasur ndikimin më të madh në jetën time?

1.3 Duke parë përpara: tre zgjedhje që formojnë të ardhmen e jetës sonë
Liria qëndron në aftësinë për të zgjedhur - apo për të mos zgjedhur

1.4 Cila punë më përshtatet mua?
Kriteret e mia për zgjedhjen e një pune

Zgjerim: Analiza e punëve

KAPITULLI 1

Identiteti

Të zgjedhim

Hyrje për mësuesit

"Kush do të jetë partneri im?"

"A duam të kemi fëmijë?"

"Cilën punë do të zgjedh unë?"

Fokusi i këtij kapitulli: zgjedhjet që formojnë identitetin

Këto janë tri nga zgjedhjet më të rëndësishme që ne bëjmë në jetën tonë. Ne kemi kërkuar përgjigjen e këtyre pyetjeve që në adoleshencën tonë dhe në të njëzetat, dhe kështu bëjnë edhe nxënësit tanë. Duke i bërë këto zgjedhje, ne formojmë identitetet tona - ne vendosim si do të jetë jeta jonë. Përmbysja e këtyre zgjedhjeve është e dhimbshme dhe e vështirë, ndërsa për fëmijët është e pamundur. Vendimet tona ndikojnë jo vetëm në jetët tona, por edhe në atë të njerëzve të tjerë.

Identiteti - Një temë intime, shumë personale

Ky kapitull për konceptin e identitetit, vjen më afër përvojave dhe dëshirave më intime të nxënësve, se sa pjesët e tjera të këtij vëllimi. Detyrat në këtë kapitull janë të konceptuara si zgjedhje. Metoda pasqyron përvojën e nxënësve.

Skica e kapitullit 1

Mësimi 1 i njeh nxënësit me rëndësinë e bërjes së zgjedhjeve. Në mësimin 2, nxënësit hedhin vështrimin pas: çfarë zgjedhjesh kanë ndikuar më shumë në jetën dhe identitetin e tyre? Në mësimin 3, nxënësit shohin në të ardhmen, duke shqyrtuar tre pyetjet kyç të mësipërme. Në mësimin 4, ata përqendrohen në një nga këto pyetje - zgjedhjen e një pune. Një projekt i analizës së punëve është sugjeruar si një zgjerim (shih fletët e punës së nxënësit 1.4).

Koncepti konstruktivist i identitetit

Në këtë kapitull, koncepti i identitetit kuptohet në mënyrë konstruktiviste. Identiteti ynë nuk qëndron atje, thjesht si diçka statike dhe e plotë, por më shumë ai zhvillohet gjatë gjithë jetës sonë, në një proces të mësuari, duke u ndikuar nga zgjedhjet që ne bëjmë. Disa zgjedhje janë të pakthyeshme; të tjerat mund të ndryshohen dhe korrigjohen, nëse ne e dëshirojmë një gjë të tillë (shiko materialet për mësuesit 1.3).

Zhvillimi i kompetencave: lidhjet me kapitujt e tjerë në këtë vëllim

Çfarë tregon kjo tabelë

Titulli i këtij manuali, *Pjesëmarrja në demokraci* përqendrohet në kompetencat e qytetarit aktiv në demokraci. Kjo matricë tregon potencialin e pasojave të bashkëpunimit ndërmjet kapitujve në këtë manual. Matrica tregon se cilat kompetenca janë zhvilluar në kapitullin 1 (rreshtat e theksuar në tabelë). Kolona e rrethuar me kornizë më të dukshme tregon kompetencat e vendimmarrjes politike dhe të veprimit – të theksuara për shkak të lidhjeve të tyre të ngushta me pjesëmarrjen në demokraci. Rreshtat e mëposhtme tregojnë lidhjet me kapitujt e tjera në këtë manual: çfarë kompetencash janë zhvilluar në këto kapitull që mbështesin nxënësit në kapitullin 1?

Si mund të përdoret kjo matricë?

Mësuesit mund ta përdorin këtë matricë si një mjet për planifikimin, në mënyra të ndryshme, e orëve të tyre në EQD / EDNJ.

- Kjo matricë ndihmon mësuesit që kanë vetëm pak orë për t'i kushtuar EQD / EDNJ: një mësues mund të zgjedhë vetëm këtë kapitull dhe të heqë të tjerët, pasi ai e di se disa kompetenca kyçe janë zhvilluar, në një masë të caktuar, në këtë kapitull - për shembull, të bërit e zgjedhjeve, të kuptuarit e pluralizmit të identiteteve, ushtrimi i të drejtave të lirisë, përgjegjësia në kryerjen e zgjedhjeve që ndikojnë edhe të tjerët.
- Matrica i bën mësuesit të vetëdijshëm për pasojat e sinergjisë që ndihmojnë nxënësit të jenë të trajnuar në mënyrë të përsëritur për kompetencat e rëndësishme, në kontekste të ndryshme, të lidhura ndërmjet tyre në shumë mënyra.

Kapitujt	Dimensionet e zhvillimit të kompetencave			Qëndrimet dhe vlerat
	Analiza dhe gjykimi politik	Metodat dhe aftësitë	Pjesëmarrja në demokraci Vendimmarrja dhe veprimi politik	
1. Identiteti	Të bërit e zgjedhjeve dhe reflektimi për ndikimin e tyre Zgjedhja e një pune dhe reflektimi për kriteret	Përdorimi i modeleve si mjete analitike Prezantimet Pjesëmarrja në diskutime	Mbushja e mendjes-identifikimi i kriterëve, i qëllimeve dhe i përparësive	Përgjegjësia - të qenët i vetëdijshëm se si zgjedhjet e mia do të ndikojnë te të tjerët Gatishmëria dhe aftësia për të qenë i ndërgjegjshëm për dëshirat, nevojat, dhe detyrimet personale
2. Përgjegjësia				Njohja e ndërsjellë
3 Diversiteti dhe pluralizmi	Zgjedhjet personale krijojnë larmi të pasur të identiteteve			
6 Qeverisja dhe politika	Vendimmarrja politike korrespondon me zgjedhjet individuale. Qëllimi i lumturisë individuale korrespondon me qëllimin e së mirës së përbashkët	Strategjitë e negocimit	Argumentimi dhe debati në publik (pjesëmarrja kur komuniteti "vendos për diçka")	Gatishmëria dhe aftësia për të dëgjuar njerëzit me interesat dhe pikëpamje të ndryshme
8 Liria			Ushtrimi i të drejtave të lirisë	

Kapitulli 1: Identiteti – Të zgjedhim

Ne formojmë jetën tonë dhe të njerëzve të tjerë

Tema e mësimit	Trajnimi i kompetencave /objektivat e të mësuarit	Detyrat e nxënësve	Materialet dhe burimet	Metoda
Mësimi 1 Këndvështrime në zgjedhjet dhe identitetin	Qartësimi i qëndrimeve dhe zgjedhjeve personale. Nëpërmjet zgjedhjeve tona, ne u tregojnë të tjerëve se cilët jemi, rreth identitetit tonë.	Nxënësit zgjedhin një citim dhe japin arsyet për zgjedhjet e tyre.	Materialet për mësuesit 1.1 (tre kopje, me citate të prera në shirita të ndara para mësimit).	Punë në grup. Diskutim plenar.
Mësimi 2 Duke vështruar pas: çfarë zgjedhjesh më bënë mua personin që jam?	Këndvështrimi autobiografik Zgjedhjet tona dhe ato të të tjerëve, kanë një ndikim vendimtar për jetët tona.	Nxënësit reflektojnë për zgjedhjet që kanë pasur ndikim të fuqishëm në jetët e tyre.	Fletët e punës së nxënësit 1.1. Tabela dhe lapustila me ngjyra të ndryshme, shirita letre (A6), zamke ose letër ngjitëse.	Punë individuale. Diskutim plenar.
Mësimi 3 Vështrimi përpara: tri zgjedhje që formojnë jetën tonë të ardhshme	Marrja e vendimeve, vendosja e prioriteteve. Të drejtat e njeriut na japin ne opsione se si të formojmë të ardhshmen tonë - ne vendosim nëse do t'i marrim ato.	Nxënësit reflektojnë për zgjedhjet kyçe që ndikojnë në jetën e tyre të ardhshme.	Fletët e punës së nxënësit 1.2 Tabela, lapustila.	Puna individuale me fletë pune. Diskutim plenar.
Mësimi 4 Cila punë më përshtatet mua?	Identifikimi, balancimi dhe përzgjedhja e kritereve sipas përparësive për një vendim. Kriteret kyç për zgjedhjet e një punë janë, "Cila punë i korrespondon interesave dhe pikave të mia të forta?"	Nxënësit zgjedhin ose refuzojë një punë dhe japin arsyet për zgjedhjet e tyre.	Fletët e punës së nxënësit 1.3. Materialet për mësuesit 1.2 (të prera në grup kartash pune, për afërsisht 10 karta më shumë se nxënësit në klasë).	Puna individuale me një broshurë. Diskutim plenar.
Zgjerim: Zgjedhja e punës	Intervistë me një ekspert; planifikimi i një projekti kërkimor. Sqarimi i opsioneve të punës.	Nxënësit planifikojnë dhe kryejnë një projekt kërkimor.	Fletët e punës së nxënësit 1.4.	Projekt.

Mësimi 1

Këndvështrime për zgjedhjet dhe identitetin

Me pikëpamjet e kujt mund të pajtohem unë?

<p>Kjo matricë përmbledh informacionin që një mësues ka nevojë për të planifikuar dhe japë mësimin.</p> <p>Trajnim i kompetencave i referohet drejtpërdrejt EQD / EDNJ.</p> <p>Objektivi i mësimit tregon atë që nxënësit dinë dhe kuptojnë.</p> <p>Detyrat e nxënësit, së bashku me metodën, formojnë bërthamën e procesit mësimor.</p> <p>Materialet në listë mbështetjen përgatitjen e mësimit.</p> <p>Koha në dispozicion jep një udhëzues të përafërt për menaxhimin e kohës së mësuesit.</p>							
Trajnim i kompetencës	Qartësimi i qëndrimit dhe zgjedhjeve personale.						
Objektivi i mësimit	Përmes zgjedhjeve tona, ne i tregojmë të tjerëve se cilët jemi, diçka në lidhje me identitetet tona.						
Detyrat e nxënësve	Nxënësit zgjedhin një citim dhe japin arsyet për zgjedhjen e tyre.						
Materialet dhe burimet	Tre kopje të materialeve për mësuesin 1.1, me citimet e prera në shirita letre të ndara para mësimit.						
Metoda	Punë në grupe. Diskutim plenar						
Koha në dispozicion	<table> <tr> <td>1. Nxënësit bëjnë zgjedhjet:</td> <td>15 min</td> </tr> <tr> <td>2. Nxënësit japin arsyet për zgjedhjet e tyre:</td> <td>15 min</td> </tr> <tr> <td>3. Nxënësit krahasojnë zgjedhjet e tyre dhe reflektojnë për to:</td> <td>10 min</td> </tr> </table>	1. Nxënësit bëjnë zgjedhjet:	15 min	2. Nxënësit japin arsyet për zgjedhjet e tyre:	15 min	3. Nxënësit krahasojnë zgjedhjet e tyre dhe reflektojnë për to:	10 min
1. Nxënësit bëjnë zgjedhjet:	15 min						
2. Nxënësit japin arsyet për zgjedhjet e tyre:	15 min						
3. Nxënësit krahasojnë zgjedhjet e tyre dhe reflektojnë për to:	10 min						

Informacion

Në këtë mësim, nxënësit bëjnë zgjedhje dhe njihen me temën e zgjedhjeve përmes përvojës së tyre personale. Kjo është një qasje e bazuar në detyrë për konceptin kompleks të identitetit, dhe jo në një qasje teorike ose me bazë tekstin dhe synon të ndihmojë nxënësit të kuptojnë se koncepti i identitetit është i lidhur në një mënyrë shumë praktike me jetët e tyre.

Komunikimi ndërmjet nxënësve sundon mësimin. Një vendosje ballore do të ishte jo produktive; prandaj, nëse është e mundur, tabelat dhe karriget duhet të vendosen rreth mureve (në formë U-je).

Përshkrimi i mësimit

1. Nxënësit bëjnë zgjedhjet

Nxënësit përcaktojnë kontekstin

Mësuesi prezanton temën. Çdo ditë, në të gjithë jetën tonë, ne bëjmë zgjedhje dhe marrim vendime - çfarë shembujsh u vijnë në mendje nxënësve? Nxënësit përgjigjen dhe japin shembuj nga përvoja e tyre. Mësuesi sigurohet që ata të flasin rreth vendimeve, por pa u futur në hollësi të mëtejshme për të diskutuar problemet ose arsyet e vendimeve të marra. Në diskutim duhet të marrin pjesë sa më shumë nxënës gjatë pesë minutave të para. Mësuesi nuk duhet të diskutojë këto deklaratat; ai vëren se cila është balanca në mes të zgjedhjeve të përditshme (blerje sanduichi apo i një ushqimi të lehtë e të nxehtë për drekë) dhe vendimet kryesore (zgjedhja e një pune). Mësuesi thekson çfarë prirjesh dolën në pah në zgjedhjet e nxënësve.

Nxënësit zgjedhin një citim

Mësuesi u shpjegon nxënësve se ata do të dëgjojnë disa citime nga autorë në vende të ndryshme, dhe nga kohët e lashta dhe moderne. Detyra e tyre është si vijon:

- Nxënësit zgjedhin një citim me të cilin ata ose bien shumë dakord ose nuk janë dakord.
- Nxënësit të cilët kanë zgjedhur të njëjtin citim formojnë një grup të vogël (deri në gjashtë anëtarë) dhe ndajnë arsyet e tyre për zgjedhjen e bërë. Grupet emërojnë një drejtues.
- Pas pesë minutash, në seancë plenare, secili folës bën një deklaratë të shkurtër për zgjedhjet. Ata lexojnë citimin dhe japin arsyet kryesore pse nxënësit në grupin e tyre ranë dakord ose nuk ranë dakord me të. Nëse nxënësit e një grupi mbajnë pikëpamje të ndryshme, atëherë duhet të raportohet ndryshimi i tyre.

Mësuesi vendos citatat në tavolinat e nxënësve, të paraqitura në shirita të veçanta letre. Me radhë çdo nxënës, pasi ka marrë thënien, e lexon atë me zë të lartë për klasën. Pastaj nxënësit fillojnë me detyrën e tyre. Mësuesi i mbikëqyr ata. Nëse grupi është shumë i madh, ai ndërhyr dhe sigurohet që nxënësit të ndahen në grupe më të vogla. Për këtë qëllim, mësuesi ka përgatitur thënie rezervë. Mësuesi merr shënim se cilat thënie kanë zgjedhur nxënësit dhe cilat nuk i kanë zgjedhur. Ai e ka të pamundur të kuptojë diskutimet e nxënësve, sepse niveli i zhurmës që prodhohet nga diskutimet e njëkohshme të nxënësve do të jetë si ai i një kafeneje të mbushur plot me klientë.


2. Nxënësit japin arsyet për zgjedhjet e tyre

Folësit japin deklaratat e tyre

Mësuesi, pasi njofton nxënësit për përfundimin e kohës së diskutimeve, i fton ata në senacë plenare, të kryesuar nga tij. Nxënësit qëndrojnë në grupe dhe folësit e tyre marrin fjalën me radhë. Nëse është e nevojshme, mësuesi i kujton folësit të raportojë për arsyet e zgjedhjes që ata kanë bërë si grup ndërkohë që nxënësit e tjereë kanë të drejtën të kërkojnë më shumë shpjegime. Mësuesi duhet të sigurojë diskutimi nuk fillon para se të kenë folur të gjithë folësit.

Mësuesi dhe nxënësit prodhojnë një hartë në mendje si një regjistrim

Para se ta marrë fjalën folësi i radhës, mësuesi i kërkon dëgjuesve të përmbledhin deklaratat kyçe që sapo kanë dëgjuar, për shembull, "Shumë nga zgjedhjet tona janë të pakthyeshme" ose "Kur bëjmë zgjedhje, kemi ushtruar të drejtat e lirisë personale." Mësuesi ose një nxënës, përmbledhin konceptet kyçe në një hartë të thjeshtë të mendjes (shih shembullin më poshtë).



3. Nxënësit krahasojnë dhe të reflektojnë për zgjedhjet e tyre

Nxënësit lexojnë hartën e mendjes - një dokument shumë zgjedhje

Harta e mendjes mbështet fazën përfundimtare të reflektimit në këtë mësim.

Mësuesi drejton një pyetje që të provokojë mendim – shumë përgjigje të ndryshme janë të mundshme, pasi nxënësve iu adresohet si ekspertë në emër të tyre: folësit kanë raportuar vetëm atë që nxënësit mendojnë në lidhje me citimet e ndryshme në përzgjedhjet e bëra. Vetë grupet u formuan nga zgjedhjet e nxënësve – kështu pra çfarë na tregon kjo hartë mendore në lidhje me studentët?

Nxënësit mund të kenë nevojë për pak kohë që të mendohen. Ata duhet ta kenë atë - çfarë mund të jetë më e mirë se një klasë plotë me nxënës që mendojnë shumë në heshtje? Prandaj kjo fazë produktive nuk duhet të ndërpritet shumë shpejt duke i dhënë menjëherë fjalën studentit të parë që ngre dorën i pari. Disa nxënës mund të flasin më vonë. Shumë pikëpamje të ndryshme, janë të mundshme, dhe ato do të ndryshojnë në varësi të kontekstit që nxënësit kanë krijuar përmes zgjedhjeve të tyre dhe sikundër është regjistruar në hartën e mendjes.

Përfundimi: deklaratat kyçe

Detyra e mësuesit është të përfundojë mësimin duke përmbledhur deklaratat kryesore për nxënësit. Ato mund të shprehen drejtpërdrejt, ose mund të ndodhin, si lajtmotiv në disa deklarata. Mësuesi shkruan në dërrasën e zezë ose tabelë fjalët kyçe për të mbështetur përmbledhjen:

1 Në këtë mësim, nxënësit kanë *bërë zgjedhje kur kanë folur për zgjedhjet.*

2. nxënësit kanë *bërë zgjedhje të ndryshme, për arsye të ndryshme* (këtu janë disa shembuj):

- Përvoja personale;
- Vlerat
- Gjininë
- Shqetësimi për të tjerët, përgjegjësia
- Të drejtat e njeriut
-

3. Zgjedhje e nxënësve tregojnë se ata janë me personalitete të ndryshme - zgjedhjet e tyre na tregojnë ne diçka rreth asaj çka ata janë, rreth *identitetit të tyre.*

Mësimi 2

Duke vështruar pas: çfarë zgjedhjesh më bënë mua personin që jam?

Cilat janë zgjedhjet që kanë pasur ndikimin më të madh në jetën time?

Kjo matricë përmbledh informacionin që i nevojitet një mësuesi për planifikimin dhe zhvillimin e mësimi.

Trajnimi i kompetencave i referohet drejtpërdrejt EQD / EDNJ.

Objektivi i mësimi tregon atë që nxënësit njohin dhe kuptojnë.

Detyra e nxënësit, së bashku me **metodën**, formojnë bërthamën e procesit mësimor.

Materialet në listën e plotë e mbështetin përgatitjen e mësimi.

Koha në dispozicion na jep një udhëzues të përafërt për menaxhimin e kohës së mësuesit.

Trajnimi i kompetencës	Këndvështrimi autobiografik.
Objektivat e të mësuarit	Zgjedhjet tona, dhe ato të të tjerëve, kanë një ndikim vendimtar për jetën tonë.
Detyrat e nxënësve	Nxënësit reflektojnë për atë se cilat zgjedhje kanë ndikimin më të fuqishëm në jetën e tyre.
Materialet dhe burimet	Fletët e punës së nxënësit 1.1. Tabelë, shirita letre (A6), lapustila në ngjyra të ndryshme, zamkë apo letër gjitëse.
Metoda	Punë individuale. Diskutim plenar.
Koha në dispozicion	1. Nxënësit hulumtojnë se çfarë zgjedhjesh kanë prekur jetën e tyre. 15min 2. Nxënësit ndajnë zbulimet e tyre. 10 min 3. Nxënësit diskutojnë dhe reflektojnë për rezultatet e tyre. 15 min

Informacion

Në një masë të madhe, zgjedhjet formojnë identitetet tona. Në këtë mësim, nxënësit shikojnë pas në jetën e tyre. Në mësimin e ardhshëm, ata ndryshojnë këndvështrim dhe shohim përpara në të ardhmen. Pyetja kryesore mbetet e njëjtë: Si e formojmë ne të ardhmen tonë dhe jetën e të tjerëve përmes zgjedhjeve që bëjmë?

Në këtë mësim, nxënësit, në fillim, reflektojnë për biografitë e tyre në kontekstin e kësaj pyetje kyç. Pastaj, ata ndajnë disa nga gjetjet e tyre në seancën plenare dhe i krahasojnë ato.

Përshkrimi i mësimit

Përgatitjet

Para se të fillojë mësimi, mësuesi nxjerrë një tabelë në mur apo në dërrasën e zezë dhe kopjon diagramën nga broshura e nxënësit 1.1.

Zgjedhjet e mia		

Zgjedhjet e njerëzve të tjerë		

Lindja	Vija e kohës	E tashmja

1. Nxënësit hulumtojnë se çfarë zgjedhjesh kanë ndikuar në jetën e tyre

Mësuesi paraqet detyrën

Mësuesi paraqet detyrën kryesore të këtij mësimi. Versioni i zmadhuar i materialit në tabelë shërben si referencë. Mësuesi rikujton mësimin e fundit: nxënësit kanë bërë zgjedhjet, dhe vetëm ky aktivitet na ofroi një pasqyrë të personaliteteve të ndryshme të tyre. Ky mësim aplikon një perspektivë të ndryshme: çfarë ndikimi kanë pasur zgjedhje në identitetin dhe zhvillimin tonë në jetë? Dhe kush i ka bërë këto zgjedhje? Ne vetë? Apo njerëzit e tjerë?

Grafiku në tabelë është i njëjtë me atë të fletëve të punës së nxënësit. Në gjysmën e sipërme, nxënësit shënojnë zgjedhjet që kanë bërë, në gjysmën e poshtme ata shënojnë zgjedhjet e bëra nga të tjerët. Vija e kohës, me kahun nga e majta në të djathtë, dëshmon jetëgjatësinë e tyre nga lindja deri në të tashmen. Nxënësit mund të tregojnë se kur një zgjedhje e caktuar ka ndikuar në identitetin e tyre.

Nxënësit përdorin këndvështrimin autobiografik

Nxënësit marrin kopjet e tyre të të fletës së punës për nxënësit 1.1 dhe punojnë individualisht në heshtje (10-15 minuta). Ata reflektojnë për përvojën e tyre personale nga këndvështrimi autobiografik. Ata janë ekspertë për veten e tyre. Për shkak të vetë natyrës intime, tema dhe informacioni është tejet i rëndësishëm për çdo nxënës, dhe ata duhet të vendosin se çfarë informacioni duhet të ndajnë me klasën në fazën e ardhshme të mësimit.

2. Krahasimi i përvojave të nxënësve

Prezantimi i detyrës

Mësuesi paraqet hapin e ardhshëm. Tani nxënësit mund të ndajnë disa nga gjetjet e tyre. Secili nxënës merr dy copa letre të madhësisë A6 dhe lapustila (këto mund të jenë të përbashkëta). Vetëm një pjesë e informacionit - një zgjedhje - duhet të shënohet në çdo shirit letre, meqenëse shiritat do të lidhen me shënimet e nxënësve të tjerë.

Mësuesi shton vite në vijën e kohës, duke filluar me vitin e lindjes të nxënësit më të madh dhe duke përfunduar me të tashmen.

Nxënësit zgjedhin një ose dy pika nga reflektimet e tyre autobiografike, duke përdorur kriteret e mëposhtme:

- Cila prej zgjedhjeve ka pasur ndikim të fuqishëm në identitetin tim?
- Cilat pjesë të informacionit jam i gatshëm për të ndarë me të tjerët në klasë?

Nxënësit duhet të tregojnë se cili e bëri zgjedhjen ("Unë", "nëna", "miku" ...), dhe kur është bërë ajo, por ata nuk duhet të vendosin emrat e tyre.

Nxënësit bëjnë një studim të përgjithshëm për zgjedhjet kyçe

Nxënësit plotësojnë një ose dy fleta letre, sipas udhëzimeve të mësuesit dhe i vendosin ato me kokë poshtë në tryeza. Një ekip prej katër nxënësish i mbledh dhe i sjell ato te tabela.

Nxënësit mblidhen rreth tabelës në një gjysmërreth - nëse është e nevojshme, në dy radhë. Një nxënës nga ekipi lexon shënimet për klasën. Një anëtar i ekipit sugjeron se ku mund të bashkëngjiten ato te tabela. Nëse ndodhin përsëritje në tabelë informacioni qëndron për të gjithë të tjerët; këto numërohen, shuma regjistrohet dhe teksti në tabelë ndahet për t'i theksuar rëndësinë. Ekipi bashkëpunon me klasën, në mënyrë që të gjithë nxënësit të marrin pjesë në tensionin, që të dhënat e tyre të përbashkëta të dalin dhe të marrin pjesë në krijimin përfundimtar.

3. Nxënësit diskutojnë dhe reflektojnë për rezultatet e tyre

Në kërkim të modeleve dhe të elementeve të rëndësishëm

Materiali është i ri për të gjithë, kështu që, përmbajtja është e vështirë të mund të parashikohet. Shpesh nxënësit nuk kanë nevojë për udhëzime ose për një pikë fillimi, por fillojnë menjëherë të bëjnë komente.

Nëse është e nevojshme, mësuesi thekson se hapi tjetër është për të identifikuar modelet ose detajet më të spikatura.


Megjithatë, ka të ngjarë të shfaqen disa modele:

Adoleshenca - rritja e autonomisë: Në fëmijërinë e hershme, të tjerët bëjnë zgjedhjet (prindërit, familja, mësuesit, mjekët). Ndërsa kur rritemi, ne bëjmë më shumë zgjedhje për veten. Pra, ka të ngjarë që të kemi grumbullime të zgjedhjeve te tabela, dhe këto mund të theksohen nga simbol i një shigjete që tregon lart -ndryshimi drejt shtimit të autonomisë dhe përgjegjësisë personale në rritje me rritjen e moshës. Një nxënës mund të shënojë shigjetën edhe në tabelë (shih më poshtë).

"Unë ia detyroj ekzistencën time prindërve të mi": Kjo është pika e fillimit, e ngjashme në biografite të gjithëve. Ajo është sa e thjeshtë, aq edhe e qartë. Ne kemi rrënjët tona në familjet tona.

Diversiteti dhe pluralizmi: Ndoshta nuk ka model që mund të zbulohet. Kjo tregon fenomenin e pluralizmit - ne ndryshojmë në zhvillimin tonë dhe zgjedhjet tona na kanë bërë ne personalitete individuale.

Zgjedhjet e mia



Zgjedhjet e njerëzve të tjerë



Me rritjen e fëmijëve rritet edhe autonomia e tyre për zgjedhjet në jetë.

Mësimi 3

Duke parë përpara: tre zgjedhje që formojnë të ardhmen tonë

Liria qëndron në aftësinë tonë për të zgjedhur - ose për të mos zgjedhur

Kjo matricë përmbledh informacionin që i nevojitet një mësuesi për planifikimin dhe zhvillimin e mësimi.

Trajnimi i kompetencave i referohet drejtpërdrejt EQD/EDNJ.

Objektivi i mësimi tregon atë që nxënësit njohin dhe kuptojnë.

Detyra e nxënësit, së bashku me **metodën**, formojnë bërthamën e procesit mësimor.

Materialet në listën e plotë e mbështetin përgatitjen e mësimi.

Koha në dispozicion na jep një udhëzues të përafërt për menaxhimin e kohës së mësuesit.

Trajnimi i kompetencës	Marrja e vendimeve, vendosja e prioriteteve.
Objektivat e të mësuarit	Të drejtat e njeriut na japin mundësi si të formojmë jetët tona në të ardhmen - ne vendosim nëse do t'i shfrytëzojmë ato.
Detyrat e nxënësve	Nxënësit reflektojnë në zgjedhjet që ndikojnë të ardhmen e tyre.
Materialet dhe burimet	Fleta e punës së nxënësit 1.2. Tabela, lapustila.
Metoda	Punë individuale me fletët e punës Diskutim plenar.
Koha në dispozicion	1 Prezantimi i temës dhe detyrës. 15min
	2. Nxënësit reflektojnë për zgjedhjet kyçe . 10 min
	3 Prezantimi dhe reflektimi. 15 min

Informacion

"Kush do të jetë partneri im?" - "A duam të kemi fëmijë?" - "Cilën punë do të zgjedh?"

Në këtë mësim, nxënësit do të shqyrtojnë zgjedhjet për çështjet e mësipërme. Duke vepruar kështu, ata e zhvendosin këndvështrimin e tyre nga e kaluara në të ardhmen. Në mësimin më parë, ata vështruan pas, duke trajtuar zgjedhjet që janë bërë (dhe nga kush) e që kanë ndikuar në mënyrë vendimtare në jetën e tyre dhe në formën e identitetit të tyre gjatë fëmijërisë dhe adoleshencës. Në këtë mësim, ata do të shikojnë në të ardhmen. Ata do të bëjnë zgjedhje të rëndësishme, për partneritetin, familjen dhe profesionin e tyre - që ndoshta kanë ndikimin më të madh në identitetin e tyre.

Nxënësit do të bëhen të vetëdijshëm për përfshirjen e çështjeve gjinore: roli tradicional i gruas ka qenë për të zgjedhur partnerin dhe familjen - pa një profesion, ndërsa burrat përqendroheshin në rolin e tyre si burim i të ardhurave (profesionit) dhe partner, me një përgjegjësi më të vogël për jetën familjare.

Sot, gratë e reja ushtrojnë të drejtën e tyre për arsimim shumë më gjerësisht, me qëllim që të zgjedhin profesionin e tyre. Kështu, ndërsa gratë përpiqen të gjejnë balancën mes tre mundësive: profesionit, partnerit dhe familjes, shumë, por jo të gjithë burrat, vazhdojnë t'i përmbahen kuptimit të rolit të tyre tradicional.

Përshkrimi i mësimit


1. Prezantimi i temës dhe i detyrës

Mësuesi përfshin nxënësit në aktivitet (qasja induktive)

Mësuesi e fillon mësimin duke drejtuar një pyetje së cilës mund t'i përgjigjet çdo nxënës dhe që qëllon në shënjë: përse ju vazhdoni shkollën në nivelin e mesëm të lartë?

Nxënësit, si meshkuj edhe femra, me siguri do të përgjigjen se ata dëshirojnë të zgjedhin një profesion. Ata gjithashtu duan të kenë mundësi pranimit në nivele të avancuara të studimit dhe trajnimit, të tilla si studimi universitar.

Mësuesi lejon disa nxënës ta marrin fjalën, derisa të shfaqet një pamje e qartë. Atëherë ai përmbledh përgjigjet e nxënësve, duke vizatuar diagramin në broshurën e nxënësve 1.2 për dërrasën e zezë ose në tabelë dhe duke shtuar zgjedhjen e parë - puna.



Mësuesi shpjegon se kjo është një zgjedhje që nxënësit e kanë dhënë si prioritetin më të lartë për momentin, dhe është e qartë sa e rëndësishme është kjo për identitetin e tyre. Duke vepruar kështu, ata ushtrojnë të drejtat e njeriut - lirinë për të bërë zgjedhje në përgjithësi, si dhe lirinë për të zgjedhur një profesion. Nxënësit mund të theksojnë, me të drejtë, se kjo liri është e kufizuar nga mundësitë e kufizuara në disa punë të caktuara, për shembull, nga papunësia apo konkurrenca e fortë. Kjo temë nuk është e nevojshme të ndiqet këtu, pasi do të trajtohet në mësimin që vijon më pas.

Mësuesi trajton zgjedhje të tjera të rëndësishme: a dua unë të jetoj me një partner, dhe nëse po, kush do të jetë partneri im? (ose, "A e kam bërë unë këtë zgjedhje tashmë?") dhe "A dëshiroj unë, apo duam ne që të kemi fëmijë?" Mësuesi shton termat "Partner" dhe "Fëmijë" në diagram, në mënyrë që ajo t'i ngjajë dhe Fletaës së punës së nxënësit 1.2.

Mësuesi shpjegon se ne të gjithë duhet t'i përgjigjemi këtyre pyetjeve, në një mënyrë apo një tjetër. Ne mund të zgjedhin t'i kombinojmë të tre alternativat, ose të kombinojmë vetëm dy dhe të lëmë një jashtë. Ne do të jetojmë jetë krejtësisht të ndryshme, në varësi të zgjedhjeve që bëjmë ose që nuk bëjmë. Ne ushtrojmë të drejtat e njeriut, por ne gjithashtu mbajmë përgjegjësinë për jetën tonë dhe atë të të tjerëve (partnerët, fëmijët tanë).

Mësuesi paraqet detyrën

Mësuesi shpërndan Fletën e punës së nxënësit 1.2. Ai i bën të vetëdijshëm nxënësit për të drejtat e njeriut që të japin alternativat kryesore të të zgjedhurit të një pune, të një jete me një partner dhe të të pasurit fëmijë (Fleta e punës së e nxënësit 1.2, pjesa 1). Detyra e nxënësve është që të mendojnë për zgjedhjet e tyre, dhe për të regjistruar vendimin e tyre në matricën në pjesën 2 të fletës së punës.

Në qoftë se dëshirojnë, ata mund të krahasojnë zgjedhjet e tyre me ato të prindërve të tyre. Ky informacion shtesë nuk do të ndahet në klasë. Informacioni për zgjedhjet e tyre do të mbetet anonim.

2. Nxënësit reflektojnë për zgjedhjet e tyre kryesore

Nxënësit punojnë individualisht në heshtje. Mësuesi nuk i shikon broshurat e tyre, meqenëse fshehtësia është e rëndësishme kur adresohen çështje të tilla delikate.

Mësuesi përgatit fazën që vijon më pas. Ai vendos një tabelë në dërrasë të zezë ose në mur. Ideale do të ishte nëse nxënësit do të ishin të mbrojtur, e të mos shiheshin kur të shkruanin për të. Tabela tregon një version të modifikuar të matricës në fletën e punës së nxënësit 1.2.

Teksti mund të reduktohet në shkronja, pasi nxënësit e njohin matricën. Legjenda e mëposhtme është e mjaftueshme:

Zanat - Partner - Fëmijë

Mundësitë për të ardhmen		Gratë	Burrat
Të tre	P + F + Z		
Dy nga tre	P + F		
	P + Z		
	Z + F		
Një në tre	P		
	Z		
	F		

Mësuesi lë lapustilat për nxënësit.

3. Prezantim dhe reflektim

Nxënësit paraqesin zgjedhjet e tyre

Mësuesi shpjegon se si nxënësit mund të shtojnë zgjedhjen e tyre fshehtas. Nga ana tjetër, secili nxënës vjen te tabela e shënon zgjedhjen e tij me një numër "një" (1).

Nxënëset femra dhe meshkuj përdorin kolona të veçanta.

Nxënësit vijnë përpara për te tabela dhe shënojnë zgjedhjen e tyre. Kur të kenë mbaruar, dy nxënës numërojnë shenjat sipas ndarjeve dhe bëjnë shumat.

Nxënësit komentojnë dhe të diskutojnë rezultatet

Rezultati vështirë se mund të parashikohet. Është interesante të shohësh, se sa të rinj e të reja synojmë të kombinojnë të tre alternativat, sa prej tyre shkojnë për dy dhe për cilat nga to.

"Partner + Zanat": Modeli mashkullor tradicional "shtylla e familjes + shtëpiake". Nxënësit duhet të bëhen të vetëdijshëm për pasojat, në qoftë se të dy partnerët bëjnë këtë zgjedhje - ky është Modeli "Dink" (të ardhura dy herë, por pa fëmijë).

"Zanat + Fëmijë": Një zgjedhje e pamundur, pasi ajo do të thotë të qenët prind i vetëm, por sikundër nxënësit e dinë, një numër i konsiderueshëm i familjeve kanë vetëm një prind, jo si zgjedhje, por për shkak të ndarjeve ose të vdekjes.

"Partner + Fëmijë": Modeli femëror tradicional nëse zgjat për gjithë jetën. Shumë nëna të reja dhe, në një shkallë më të vogël, etër të rinj e pranojnë këtë alterantivë për kohën që kujdesen për fëmijët e tyre, kur ata janë shumë të vegjël. Është e kuptueshme që ata do të kthehen në punët e tyre, sa po të munden.

"Zanat + Partner + Fëmijë": nxënësit do të dinë se kjo alterantivë është një sfidë. A ka ndonjë ndryshim në zgjedhjet e bëra nga secila gjini? Ka më shumë gjasa që më shumë femra se sa meshkuj të rinj do të zgjidhnin këtë alterantivë. Nëse po, cilat janë arsyet për këtë? Mësuesi nuk duhet të

ushtrojë presion për nxënësit nëse ata nuk janë të gatshëm të flasin për arsyet për zgjedhjet e tyre. Mësuesi mund të nxjerr në pah, megjithatë, se ky është një shembull se si zgjedhjet individuale mund të ndikojnë shoqërinë si një e tërë: në qoftë se shumë prej tyre nuk zgjedhin për të pasur fëmijë atëherë do të bjerë lindshmëria. Pa ushtruar presion moral, nxënësit duhet të bëhen të vetëdijshëm për pasojat afatgjata që zgjedhjet e tyre individuale do të kenë në mënyrë të pashmangshme (shih zgjerimin më poshtë).

Me këto linja të mundshme mendimi, mësuesi pret rezultatet, dhe më pas i përgjigjet, nëse është e nevojshme, duke improvizuar. Reflektimi paraprak, siç është përcaktuar këtu, ndihmon; dhe po kështu vepron edhe vlerësimi i mësimit më pas, për të zhvilluar kapacitetet dhe besimin në improvizim.

Zgjerim

Problemi i rënies së numrit të lindjeve dhe plakjes ose pakësimit të popullsisë është shfaqur në shumë vende të industrializuara dhe të zhvilluara në të gjithë botën, duke përfshirë Kinën, Gjermaninë dhe Italinë. Probleme serioze mund të lindin për sistemet e ekonomisë dhe të pensioneve të moshave të kaluara.

Me të dhënat statistikore, nxënësit mund të hetojnë situatën në vendin e tyre. Ata mund të analizojnë dhe gjykojnë për zgjedhjet.

Mësimi 4

Cila punë më përshtatet mua?

Kriteret e mia për zgjedhjen e një pune

<p>Kjo matricë përmbledh informacionin që i nevojitet një mësuesi për planifikimin dhe zhvillimin e mësimit.</p> <p>Trajnimi i kompetencave i referohet drejtpërdrejt EQD / EDNJ.</p> <p>Objektivi i mësimit tregon atë që nxënësit njohin dhe kuptojnë.</p> <p>Detyra e nxënësit, së bashku me metodën, formojnë bërthamën e procesit mësuesor.</p> <p>Materialet në listën e plotë e mbështetin përgatitjen e mësimit.</p> <p>Koha në dispozicion na jep një udhëzues të përafërt për menaxhimin e kohës së mësuesit.</p>	
Trajnimi i kompetencës	Identifikimi, balancimi dhe përparësitë e kriterëve për një vendim.
Objektivat e të mësuarit	Kriteret kryesore për zgjedhjen e një punë janë, "Cila punë korrespondon me interesat dhe pikat e mia të forta?"
Detyrat e nxënësve	Nxënësit zgjedhin ose refuzojnë një punë dhe japin arsyet për zgjedhjen e tyre.
Materialet dhe burimet	Fletët e punës së nxënësit 1.3. Materiale për mësuesit 1.2 (prisni një grup të kartave të punës, përafërsisht 10 copë karta më shumë se sa numri i nxënësve në klasë).
Metoda	Punë individuale me fletët e punës Diskutim plenar.
Koha në dispozicion	1. Nxënësit pranojnë ose refuzojnë një ofertë pune. 20min
	2. Nxënësit ndajnë mes tyre kriteret për zgjedhjen e një pune 20 min

Informacion

Në mësimin 1.3, nxënësit trajtuan tri çështje kyçe që ata mendojnë që do të ndikojnë thellësisht në jetën e tyre të ardhshme: duke bërë zgjedhje në lidhje me punët e tyre, të partnerit dhe familjes (të qenit prind). Në këtë mësim, nxënësit shqyrtojnë më në thellësi kriteret e përfshira në një nga këto zgjedhje, për shembull, zgjedhjen e një pune

Dy kriteret janë me rëndësi të veçantë: Cila punë më intereson mua? Cilën punë mund të bëj më mirë?

Rëndësia e këtyre pyetjeve është e qartë, po kështu janë edhe vështirësitë për t'u përgjigjur atyre, veçanërisht të dytës. Për këtë qëllim nevojitet informacion konkret; projekti i përzgjedhjes së punës është sugjeruar që nxënësit të mund të kapërcejnë këtë problem.

Përshkrimi i mësimit

1. Nxënësit pranojnë ose të refuzojnë një ofertë pune

Mësuesi prezanton temën

Mësuesi prezanton temën, duke iu referuar tabelës që tregon trekëndëshin e zgjedhjeve kryesore. Mësimin e kaluar, nxënësit diskutuan vështirësitë në bërjen e tre zgjedhjeve të rëndësishme për jetën: në lidhje me punën, partneritetin dhe familjen e tyre.

Në këtë mësim, nxënësit do përqendrohen në një nga këto tri zgjedhje - punën e tyre të ardhshme.

Mësuesi shpjegon se, për të filluar, nxënësit duhet të imagjinojnë se tani do t'u ofrohet një punë. Mësuesi do t'u paraqesë atyre ofertën e punës në një kartë. Ata janë të lirë të vendosin nëse do të pranojnë këtë ofertë apo jo.

Mësuesi prezanton metodën - një simulim i thjeshtë i tregut të punës

Mësuesi shpërndan fletën e punës së nxënësve 1.3 dhe kërkon nga nxënësit të plotësojnë rreshtin e parë: A e kanë ata një punë të parapëqyer ose "A e kanë bërë zgjedhjen e tyre? Nëse jo, ata presin për hapin e ardhshëm.

Mësuesi shpjegon rregullat. Kur nxënësit marrin ofertën e tyre të punës në kartë, ata vendosin nëse do ta pranojnë apo jo. Ata shënojnë arsyet e tyre në fletën e punës.

Pastaj ata mund të shikojnë për një punë tjetër. Nxënësit mund të bien në ujdi për të ndryshuar punët me njëri-tjetrin ose të shkëmbejnë kartat e tyre me një nga kartat në tavolinë e mësuesit. Ata regjistrojnë të gjitha punët e ofruara për ta dhe japin arsyet për pranimin ose refuzimin e tyre.

Nëse ata gjejnë një punë që u pëlqen, atëherë ata mbajnë kartën e vendit të punës. Nëse ata e lënë kartën pa marrë një tjetër, atëherë ata janë të papunë.

Para se të fillojë simulimi i tregut të punës, nxënësit duhet të kenë një ide të qartë për rregullat dhe rolet e tyre.

Mësuesi shpërndan një kartë pune për çdo nxënës. Disa ndoshta do të protestojnë dhe mund të dëshirojnë ta heqin qafe ofertën e punës së tyre menjëherë. Nëse është e nevojshme, mësuesi i kujton ata për detyrën e tyre - të regjistrojnë në fletën e punës arsyet për mos dashjen e një pune të caktuar.

Nxënësit marrin pjesë në simulimin e tregut të punës - në kërkim të një pune

Pasi nxënësit kanë marrë kartat e punës, ata lihen individualisht. Mësuesi vëren se sa nxënës pranojnë ofertat e tyre të punës, dhe i kujton nxënësit të bëjnë shënime të shkurtra para ndërrimit të vendeve të punës.

2. Nxënësit ndajnë kriteret e tyre për zgjedhjen e një pune

Nxënësit identifikojnë kriteret kryesore për zgjedhjet e tyre të punës

Nxënësit janë ulur në një kuadrat ose rreth të hapur për të mbështetur dhe lehtësuar komunikimin.

Mësuesi i kërkon të tregojnë duart. Kush ka pranuar një ofertë pune? Kush nuk ka pranuar?

Në një hap të dytë, mësuesi kërkon nga nxënësit që të formojnë grupet me 4-6 veta dhe të ndajnë kriteret e tyre. Detyra e tyre është të paraqesin një listë me tre kriteret kryesore të cilat ata i kanë pranuar.

Pas pesë minutash, folësit e grupit paraqesin rezultatet dhe një anëtar tjetër i grupit shkruan pikat e tyre në dërrasën e zezë ose në tabelë. Pikat që përzgjidhen edhe nga grupet e tjerë shënohen për të theksuar rëndësinë e tyre. Rezultati mund të duket kështu:

Cila punë më përshtatet mua? Kriteret për zgjedhjen e një punë

Interesat personale
Kualifikimet - kërkesat e punës
Të ardhura të mira
Orari i punës
Fleksibiliteti
Siguria në punë
...

Nxënësit identifikojnë kriteret kryesore për zgjedhjen e një pune

Nëse grupet, në mënyrë të përsëritur, kanë përmendur disa kriteret për zgjedhjen e një pune, ata tani analizojnë nëse këto janë veçanërisht të rëndësishme. Ata ndajnë mendimet e tyre dhe japin arsyet.

Nga njëra anë, nxënësit janë të lirë të ndjekin preferencat e tyre personale, kështu që nuk është e nevojshme që ata të bien dakord. Për shembull, një e ardhur e lartë mund të jetë më e rëndësishme për një nxënë, ndërsa një tjetër këmbëngul në një fundjavë të lirë dhe orar fleksibël të punës. Megjithatë, në një pikë të caktuar, mësuesi duhet t'i bëjë nxënësit të vetëdijshëm për këto.

Ne të gjithë duam të shmangin të qenët i papunë, kështu që është mjaft e kuptueshme se siguria e punës është, shpesh herë, një përparësi e lartë. Megjithatë, zhvillimet e biznesit janë shumë të paparashikueshme dhe nxënësit do të hasin konkurrencë kudo. Ata duhet të zgjedhin një punë ose, të paktën, një kategori të punës ("Drejtësinë" - "Doktor në mjekësi"), kur të largohen nga shkolla, dhe për këtë do të aplikojnë pasi të kenë mbaruar studimet ose trajnimin. Askush nuk mund të parashikojë në mënyrë të besueshme se çfarë shansesh do të ketë pas katër ose pesë vitesh.

Për këtë qëllim, nxënësit duhet të përfshijnë dy kriteret:

1. Çfarë më intereson mua dhe çfarë do të më pëlqente mua të bëj?
2. Çfarë mund të bëj unë mirë? Ku janë pikat e mia të forta? Çfarë mund të bëj më mirë kur të përballem me konkurrencën?

Mësuesi u jep nxënësve pak kohë për të menduar për këto pika dhe për t'u përgjigjur.

Nxënësit problematizojmë zbatimin e kriterëve

Kur reflektojnë për mënyrën se si t'i zbatojnë këto dy kriteret kryesore në përzgjedhjen e një pune, nxënësit do të bëhen të vetëdijshëm për vështirësitë e përfshira. Pyetja e dytë më lart është më e lehta për t'ju përgjigjur. Me ndihmën e prindërve dhe miqve të tyre, ata mund të eksplorojnë profilin e tyre specifik të kompetencave.

Pyetja e parë paraqet më shumë probleme, pasi nxënësit kanë nevojë për informacion për kërkesat e punës dhe zhvillimet e vendeve të punës. Mësuesit nuk janë ekspertë profesionistë të karrierës, kështu që shkolla këtu është në kufijtë e saj fundorë dhe nxënësit duhet të gjejnë informacion në mënyrë individuale. Ata tani përjetojnë lirinë e zgjedhjes dhe të ndërtimit të identitetit, si një biznes me të vërtetë kërkues.

Në shumë vende, shkollat i mbështetin nxënësit e tyre përmes skemave të vëzhgimit të profesioneve. Ky model është sugjeruar si një zgjerim që nxënësit, prindërit, dhe menaxherët e biznesit do ta vlerësonin dhe mbështetnin.

Zgjerim: Projekti vëzhgimi i një profesioni

Problemet me të cilat përballen nxënësit dhe si mund të ndihmojnë projektet e vëzhgimit të profesionit

Nxënësit e dinë se sa e rëndësishme është zgjedhja e tyre për një pune të përshtatshme për jetën e tyre të ardhshme. Ata e kanë kuptuar se cilat kritere janë më të rëndësishme kur bëjnë zgjedhje, por ata kanë kuptuar gjithashtu se nuk mund të gjykojnë se cilat kërkesa të punës plotësohen nga talentet, kompetencat dhe interesat e tyre pa pasur një informacion të plotë më të fundit. Projekti i vëzhgimit të një profesioni mund t'u japë nxënësve mbështetje të vlefshme në marrjen e atij informacioni.

Detyra e nxënësve

Nxënësit kërkojnë një punë që ata besojnë se i plotëson kriteret e tyre. Ata kalojnë disa ditë në punë me një profesionist. Ata vëzhgojnë çka ai bën dhe bashkëpunojnë me të. Të udhëhequr nga një pyetësor (shih Fletën e punës së nxënësit 1.4) ata intervistojnë partnerin e tyre të punës. Nëse është e mundur, ata kryejnë detyrat për të marrë përvojën e parë (të tilla si në stazh). Orari i shkollës zëvendësohet nga orari i punës. Pra, nëse një kirurg fillon të operojë në 6 të mëngjesit, nxënësi duhet të jetë pranë tij në sallën e operacionit (për të zbuluar, për shembull, nëse ai mund të durojë për të parë një operacion).

Nxënësit shkruajnë një raport në bazë të pyetësorit. Raporti mund të dorëzohet në dhe të shënohet, e cila krijon një nxitje të mëtejshme për nxënësit që ta marrin detyrën e tyre seriozisht. Nxënësit këshillohen që të mbajnë shënime të përditshme dhe shkruajnë raportin e tyre gjatë javës së punës dhe jo më vonë - një ushtrim për menaxhimin efikas të kohës.

Raporti duhet të jetë një tregim sistematik dhe jo një ditar personal, për të siguruar që nxënësit të përqendrohen në kriteret kryesore për zgjedhjen e një pune.

Nxënësit duhet t'i gjejnë partnerët e tyre të punës vetë, me mbështetje të prindërve të tyre, familjeve dhe miqve të familjes. Në mënyrë ideale, ata nuk duhet të vizitojnë prindërit ose të afërmit e tyre në vendin e punës.

Mbështetje nga shkolla dhe mësuesit

Nxënësi luan rolin kryesor dhe është përgjegjës për rezultatet. Shkolla siguron mundësinë, përcakton kuadrin, autorizon projektin dhe sqaron çështjet ligjore (pëlqimin nga një ministri përkatëse, sigurimet). Në një fazë të hershme, shkolla kontakton edhe prindërit, të cilët kanë një rol të rëndësishëm për të luajtur (shih më poshtë).

Me kërkesë, nxënësve mund t'u jepet një letër autorizimi kur të kërkojnë një mundësi për të vëzhguar një profesion. Pasi projekti ka përfunduar, drejtori shkruan një letër falënderimi për të gjithë partnerët që kanë pritur nxënësit.

Nëse është e mundur, mësuesi duhet t'i vizitojë nxënësit gjatë projektit. Gjatë gjithë projektit, një mësues duhet të jetë në dispozicion në telefon për të reaguar shpejt në rast të një emergjence.

Punë në vijim

Ne rekomandojmë mbajtjen e raporteve për të theksuar rëndësinë e tyre. Mësuesi duhet t'i trajtojë raportet me respekt, pasi ato janë dokumente personale. Ai duhet të kuptojë se nuk ka qenë i pranishëm gjatë projektit dhe intervistave, kështu që nxënësit janë ekspertët në këtë rast, në vend të mësuesit. Pra, vlerësimi duhet të përqendrohet në aspekte të tilla si qartësia, koherenca, kujdesi dhe tërësia. Nga këndvështrimi i nxënësit, kjo lloj detyre është shumë më e dobishme se çdo provim tjetër dhe mësuesi duhet të jetë i përgatitur për të vlerësuar me nota më të mira se zakonisht.

Nxënësit duhet të kenë mundësinë për të ndarë përvojat e tyre. Kjo kërkon më shumë kohë se sa mund të sigurohet brenda mësimeve të rregullta të EQD ose studimeve sociale. Një platformë e dobishme do ishte një skanim i punëve brenda shkollës. Kjo është me interes të veçantë për nxënësit më të rinj të cilët do ta kryejnë këtë projekt një vit më vonë, por edhe për prindërit e tyre.

Partnerët e punës apo shtypi lokal, si dhe përfaqësues të bizneseve lokale mund të ftohen për këtë veprimtari.

Mbështetje nga prindërit

Së pari, prindërit mund të mbështesin fëmijët e tyre për të gjetur se ku janë pikat e forta dhe interesat e tyre. Prindërit i njohin fëmijët e tyre që nga dita e parë dhe mund të kujtojnë zhvillimin e tyre nga një këndvështrim që ndryshon nga ai i një profesionisti në shkollë. Prindërit zakonisht i mirëpresin këtë lloj projektesh dhe vlerësojnë çdo lloj mbështetje për fëmijët e tyre në gjetjen e një pune. Për arsye shumë të kuptueshme, prindërit priren për të mbivlerësuar sigurinë në punë. Në një ekonomi që ndryshon me shpejtësi, prindërit janë më pak të përshtatshëm si këshilltarë në planifikimin e karrierës.

Si të gjejmë një partner pune për nxënësit

Zakonisht nxënësve u kërkohet të gjejnë një këshilltar për projektin e tyre të gjetjes së punës. Prindërit e tyre, dhe në disa raste të afërmit ose miqtë e tjerë, mund të japin ndihmë të vlefshme nga lidhjet me partnerë të mundshëm. Nxënësit nuk duhet të bëjnë kompromis shumë shpejt në qoftë se kërkimi provon i vështirë. Ata po kërkojnë një mundësi për skanim pune, jo një punë të vërtetë. Nëse nuk mund të gjendet asnjë njeri që kryen një punë të veçantë, p.sh. një gazetar radioje, atëherë duhet të shihet për një kompromis për të kërkuar një alternativë brenda të njëjtës kategorie pune, për shembull, një gazetar që punon për gazetën lokale.

Mbështetja nga bizneset dhe institucionet vendore

Për çdo profesionist, pritja e një nxënësi për një javë pune kërkon një përpjekje të madhe dhe kjo duhet të vlerësohet. Megjithatë, shumë punëdhënës janë të interesuar në tërheqjen e aplikantëve të kualifikuar dhe të mirë-informuar për punën dhe, nga pikëpamja e tyre, vëzhgimi i një profesioni është një mundësi për të testuar nxënësit dhe ndoshta edhe t'i afrojnë ata me një ofertë për më vonë.

Nxënësit kanë nevojë për një këshilltar ose mbikëqyrës. Ky mund të jetë partneri i tyre i punës, apo dikush tjetër. Nxënësve u është dhënë leje nga shkolla, kështu që ata nuk duhet të paguhen gjatë kryerjes së projektit. Ata janë atje për të bërë punë të rregullt, por edhe të ndjekin agjendën e tyre, si është përshkruar nga pyetësi (Fleta e punës së nxënësit 1.4).

Pasojat afatgjata për nxënësit

Përvoja ka treguar se ky projekt do të ndihmojë shumë nxënës për të pasur një qasje më serioze, më të pjekur në vitet e tyre të fundit në shkollë. Ata janë bërë të vetëdijshëm për interesat e tyre, dhe tani mund të vlerësojnë më shumë disa lëndë të caktuara të cilat mund t'i lidhin me të ardhmen e tyre pas shkollës. Gjithashtu, atyre u bën përshtypje nëse dikush jashtë shkollës u ka thënë se "drejtshkrimi dhe kaligrafia kanë rëndësi." Dhe është një eksperiencë e dobishme dhe emocionuese në se nxënësit zbulojnë se ata, në fakt, mund të përballen me një numër të madh detyrash në botën profesionale.

Nxënësit mund të kthehen në shkollë me një përgjigje të qartë. Ndoshta ata tani e dinë se cila do të jetë puna e tyre dhe mund të ndër marrin hapat e ardhshëm në planifikimin e studimeve ose trajnimit të tyre pas largimit nga shkolla. Nga ana tjetër, në qoftë se projekti i tyre ka treguar se duhet të kërkojnë për një punë tjetër, edhe ky është një hap i vlefshëm përpara, pasi ata kanë larguar disa iluzione dhe mund të kërkojnë më me saktësi se çfarë lloj pune do t'u përshtatet.

Informacion për skemat e vëzhgimit të vendeve të punës

Mbretëria e Bashkuar: www.prospects.ac.uk
Baden-Württemberg, Gjermani: www.schule-bw.de/schularten/gymnasium/bogy

Materialet për mësuesit 1.1: Citate për zgjedhjet dhe identitetin

<p>Nga zgjedhjet dhe veprimet e jetës sonë, ne krijojmë personin që jemi dhe fytyrat që shpalosim. Kenneth Patton</p>
<p>Vendimi është një rrezik i rrënjosur në guximin për të qenë i lirë. Paul Tillich</p>
<p>Çdo gjë që bëni tani është diçka që ju keni zgjedhur të bëni. Disa njerëz nuk duan ta besojnë këtë. Por, nëse jeni më shumë se njëzet e një vjeç, jeta juaj është ajo çka ju bëni me të. Për të ndryshuar jetën tuaj, ju keni nevojë të ndryshoni prioritetet tuaja. John C. Maxwell</p>
<p>Unë besoj se ne jemi përgjegjës të vetëm për zgjedhjet tona dhe duhet të pranojmë pasojat e çdo veprimi, fjale dhe mendimi, gjatë gjithë jetës sonë. Elisabeth Kubler-Ross</p>
<p>Nëse doni të thuhet diçka, kërkojani një burri. Nëse doni të bëhet diçka, kërkojani një gruaje. Margaret Thatcher</p>
<p>Liria, në kuptimin konkret të fjalës, konsiston në aftësinë për të zgjedhur. Simone Weil</p>
<p>Mendjet më të mëdha janë të afta për veset më të mëdha si dhe për virtytet më të mëdha. Rene Dekarti</p>
<p>Gjëja kryesore që mund të na mësojë historia është se veprimet e njeriut kanë pasojë dhe se zgjedhje të caktuara, pasi bëhen nuk mund të zhbëhen. Ato përjashtojnë mundësinë për të bërë zgjedhje të tjera dhe kështu përcaktojnë ngjarjet e ardhshme. Gerda Lerner</p>
<p>Fuqia e zgjedhjes mirë dhe keq është brenda mundësive të gjithë njerëzve. Origeni</p>
<p>Vetëvetja nuk është diçka e gatshme, por diçka në formim të vazhdueshëm përmes zgjedhjeve dhe veprimit. John Dewey</p>
<p>Gjëja që gratë duhet ende ta mësojnë është se askush nuk ta jep pushtetin. Ju thjesht e merrni atë. Roseanne Barr</p>
<p>Kur zgjedh mes dy të këqijave, unë gjithmonë pëlqej të provoj atë që nuk e kam provuar kurrë më parë. Mae West</p>
<p>Gratë dhe macet do të bëjnë atë dëshirojnë, burrat dhe qentë duhet të relaksohen dhe të mësohen me idenë. Robert A. Henlein</p>
<p>Ju duhet të trajtoni intuitën tuaj - ju duhet të besoni zërin e vogël brenda jush, i cili ju tregon saktësisht se çfarë të thoni, çfarë të vendosni.</p>

Ingrid Bergman

Një anije noton në lindje,
Dhe një tjetër në perëndim,
Më vete - të njëjtat erëra fryjnë,
'Është fuqi e velave
Dhe jo shtrëngatave,
Që tregon ku ne shkojmë.
Ashtu si erërat në det
Janë dhe valët e kohës,
Në udhëtimin e jetës sonë,
'Është vetë shpirti,
Që përcakton qëllimin,
Dhe jo të qetësia apo furtuna.
Ella Wheeler Wilcox

www.wisdomquotes.com

Materiale për mësuesit 1.2: Kartat e punës

Nëpunës civil (administrata e bashkisë lokale)	E drejta e autorit të reklamës	Kirurg veterinar
Arkitekt	Fotograf mode	Mësuesi i shkollës fillore
Inxhinier mekanik	Menaxher i operacioneve të ujit	Bankier
Mjek spitali	Menaxher i një restoranti të ushqimit të shpejtë	Bibliotekar publik
Profesionist shitjesh IT	Oficer policie	Avokat
Guidë turistike	Shitës dyqani	Infermier Spitali


Ekonomist	Hartograf	Parukier
Kërcimtar	Gazetar	Librashitës
Meteorolog	Psikoterapist	Pilot
Pastrues dhome	Shofer autobusi	Elektricitist

Burimi: www.prospects.ac.uk

Njësia 1.3 Të dhëna shtesë për mësuesit

Konceptit konstruktivist i identitetit

E lidhur me konceptin e identitetit, konstruktivizmi do të thotë se ne i formojmë identitetet tona nga zgjedhjet dhe vendimet që bëjmë. Konstruktivizmi thekson rolin aktiv të individit dhe vë theksin në elementin e të mësuarit të përfshirë në të. Në jetë, ne bëjmë gabime dhe bëhemi të vetëdijshëm për gabimet në zgjedhjet e bëra. Ne mund të jemi në gjendje për të ndrequr disa zgjedhje (i analizojnë) dhe t'i korrigjojmë ato, por disa zgjedhje janë të pakthyeshme. Koha, për të gjitha gjërat, mund të kalojë vetëm një herë në jetë. Konstruktivizmi lidh dinamikën e bërjes së zgjedhjeve me rezultatin, identitetin tonë, gjë që bëhet statike dhe e qëndrueshme deri në një masë të caktuar.



Ky kapitull përqendrohet në rolin aktiv që ne kryejnë në formimin e identitetin tonë dhe të njëri-tjetrit, në të cilët ne kemi gjithashtu një rol pasiv. Natyrisht, zhvillimi i identitetit është shumë më kompleks dhe varet nga shumë faktorë të tjerë (ndryshore) që përcaktojnë apo kufizojnë shanset tona për të krijuar jetën dhe identitetin tonë. Këto përfshijnë origjinën, klasën, gjininë, kushtet ekonomike dhe kulturore, si dhe mjedisin natyror.

Ka dy arsye pse ky kapitull përqendrohet në dimensionin konstruktivist të formimit të identitetit tonë përmes zgjedhjeve. Së pari, kjo qasje e lidh identitetin me të drejtat e njeriut. Të bërit e zgjedhjeve është një akt lirie. Së dyti, nxënësit kuptojnë këtë qasje më mirë, pasi ajo korrespondon me përvojën e tyre dhe pyetjet që ata i drejtojnë vetes së tyre.

Jo vetëm koncepti i identitetit që është shumë më kompleks se sa duket në këtë kapitull; e njëjta vlen edhe për konceptin e zgjedhjes. Diagrami i mësipërm përshkruan qasjen didaktike të kësaj kapitulli: nxënësit eksplorojnë lidhjet mes dy koncepteve komplekse, por asnjë prej koncepteve në tërësinë e tyre të plotë.